

NewsLetter 20



Years

THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

OPINION EKONOMIK

SFIDAT E HR DHE DREJTUESVE NË NORMALITETIN E RI

Monika Farka

Managing Partner / AIMS International – Albania

Pas situatës jo normale për biznesin në këto muajt e fundit, HR dhe drejtues në gjithë botën po përballen me shumë sfida në lidhje me strategjitë e menaxhimit të talenteve në normalitetin e ri pas COVID-19. AIMS International, një nga 10 kompanitë me të mëdha në bote në konsulencën për kapitalin njerëzor, me më shumë se 90 zyra në mbi 50 vende të botës, ka organizuar tryeza të rrumbullakëta virtuale për drejtuesit e lartë dhe liderët e bizneseve të kompanive, industrive...

» Vizion në faqen 3

SPECIALE

NDËRPRERJA BRENDË NATËS DHE E ARDHMJA E REKLAMIMIT

Juella Isaj

CEO / DDB Albania

Në mars kur ndodhi mbyllja, askush nuk e kishte imagjinuar se e ardhmja do të ndryshonte në mënyrë kaq dramatike brenda natës. Vit pas viti, industria e reklamave është duke u shndërruar me shpejtësi. Transformimi dixhital në të gjitha nivelet ka qenë një nga sfidat kryesore të kësaj industrie. Ndërtimi i kapaciteteve, të dhënat që komunikojnë përmes krijimtarisë ishin procese që duhej të viheshin në zbatim brenda natës.

» Në faqen 4

BIZNESI

FATURA ELEKTRONIKE,

gjithçka që duhet të dini



Eshtë botuar në Fletoren Zyrtare, udhëzimi që përcakton elementet bazë dhe teknikat e faturës elektronike që nga emri i tatimpaguesit, datën dhe sasinë e mallit të shitur, si dhe mënyrën e kryerjes të pagesës etj. Pjesë e këtij procesi do të jenë të gjitha bizneset e regjistruara në vend, por në fasha të ndryshme kohore të përcaktuara dhe në udhëzim. Aktualisht në 1 shtator 2020 do të fillojë procesi i fiskalizimit për bizneset me xhiro mbi 8 milionë lekë. Ndërkohë në 1 janar 2021 do të fillojë për të gjitha bizneset e tjera. Ministria e Financave i ka kërkuar bizneseve

të fillojnë të përgatiten për sistemin e ri të fiskalizimit i cili do të sjellë ndryshime madhore në mënyrën se si faturojnë.

Tashmë është detyrë e bizneseve të informohen në kohë mbi detyrimet që rrjedhin nga sistemi i ri i fiskalizimit Udhëzuesi përcakton se kush do të jenë lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese, procedurën e lëshimit dhe shkëmbimit të faturave elektronike dhe dokumenteve shoqëruese, marrjen dhe dërgimin e mesazheve për faturat elektronike në pamundësi të lëshimit dhe shkëmbimit të faturës elektronike për transaksione pa para

në dorë dhe për transaksione me organet publike, në përputhje me ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"

Lëshimi i faturave shoqëruese të fiskalizuarat tashmë do të jetë detyrim edhe për transportin e mallrave nga një biznes në tjetrin brenda vendit. Fatura elektronike sipas Udhëzimit të Financave duhet të jetë në përputhje me standardet shqiptare dhe dokumentacionit të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit e Shqipërisë...

» Vizion në faqen 2

COVID 19- ECONOMIC

NEWS

KRIZA ZBEH RIMBURSIMIT E TVSH-SË, NË RËNIE VJETORE 4-MUJORE ME 11%

» Në faqen 6

Akti Normativ

“Për Ndryshimet në Aktin Normativ Nr.9, datë 25.03.2020, Për Masat Speciale në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë Situatës Epidemike të shkaktuar nga Covid-19”.

» Në faqen 5

Laimë Anëtarësh

Welcomes
New Members

“DEKON FRIGO Një kompani e specializuar në importimin, shpërndarjen, paketimin dhe përpunimin e produkteve të mishit.

» Në faqen 5



» Vijn nga faqja 1

AFATE KOHORE TË ZBATIMIT TË PROCESIT TË FISKALIZIMIT


- » **1 shtator 2020**, do të nisë për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim fitimit me të ardhura vjetore mbi **8 milionë lekë**;
- » **1 janar 2021**, për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore mbi **2 milionë lekë**;
- » **1 janar 2021**, për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore deri në **2 milionë lekë**;
- » **1 janar 2021**, për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike;
- » **1 korrik 2021**, për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve.

ELEMENTET BAZË TË FATURËS ELEKTRONIKE

Fatura elektronike duhet të përmbajë elementët bazë të mëposhtëm:

- a) titullin "Faturë tatimore" specifikohet me kodin e llojit të faturës (në specifikimet e dhëna BT-3);
- b) datën (në specifikimet e dhëna BT-2) dhe kohën e lëshimit të faturës (orë, minuta dhe sekonda) (në specifikimet e dhëna BG-1);
- c) numrin e faturës (në specifikimet e dhëna BT-1);
- d) numrin unik të identifikimit të shitësit (në specifikimet e dhëna BT-29);
- e) emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin e shitësit (në specifikimet e dhëna BT-27);
- f) adresën e shitësit (në specifikimet e dhëna BG-5);
- g) numrin unik të identifikimit, emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit. Ky informacion kërkohet vetëm nëse blerësi është: i. tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, ose subjekt i TVSH-së, në përputhje me ligjet përkatëse; ii. një person juridik; iii. një person që blen pasuri personale me vlerë individuale mbi 500,000 lekë; ose në raste të tjera, kur blerësi kërkon që në faturë të vendosen të dhënat e tij identifikuese (në specifikimet të dhënat BT-46, BT-44 dhe BG-8);

FATURA ELEKTRONIKE, gjithçka që duhet të dini



- i) kodin e operatorit sipas nenit 3, pika "g", të ligjit, i dhënë në përputhje me nenin 15, të ligjit (në specifikimet e dhëna BG-1);
- j) kodin e vendit të ushtrimit të veprimitarisë së biznesit sipas nenit 3, pika "ll", të ligjit, i dhënë në përputhje me nenin 14 të ligjit (në specifikimet e dhëna BG-1);
- j) sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura, dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera, çmimin për njësi, pra identifikuesit e artikujve të faturës, kodin e njësisë matëse të shumave të llogaritura (në specifikimet të dhënat BT-126, BT-129, BT-130, BT-146 dhe BT-153);
- k) shumën e plotë (në specifikimet të dhënat BT-106 and BT-131);
- l) shumën totale për t'u paguar (në specifikimet e dhëna BG-22); m) monedhën dhe kursin e këmbimit nëse shumat në faturë nuk shprehen në monedhën kombëtare shqiptare (lekë) (në specifikimet të dhënat

- n) udhëzimin e pagesës/mënyrën e pagesës (kartëmonedha dhe monedha, karta, çek, transaksion bankar, mandat pagese, para elektronike, pagesa të tjera pa para në dorë) (në specifikimet e dhëna BG-16)
- o) Numrin Identifikues të Veçantë të Faturës (NIVF), i shprehur si një shenjë alfanumerike (në specifikimet e dhëna BG-1);
- p) Numrin e Sigurisë të Lëshuesit të Faturës (NSLF), i shprehur si një shenjë alfanumerike (në specifikimet e dhëna BG-1); q) etiketën e procesit (në specifikimet e dhëna BT-23);
- r) specifikimet e identifikuesit (në specifikimet e dhëna BT-24); s) adresën e postës elektronike të shitësit (në specifikimet e dhëna BT-34);
- t) adresën e postës elektronike të blerësit (në specifikimet e dhëna BT-49).

ELEMENTE SHITESË PËR FATURAT ME TVSH:

- a) detajet e çmimit, siç janë çmimi për njësi pa TVSH, zbritjet mbi çmimin (në specifikimet e dhëna BG-29);
- b) shumata bazë e kategorisë së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-116);
- c) shumata e kategorisë së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-117);
- d) kodi i kategorisë së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-118); e) kategoria e normës së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-119);
- f) shumata totale e TVSH-së së faturës (në specifikimet e dhëna BT-110);
- g) shumata totale e faturës me TVSH (në specifikimet e dhëna BT-112);
- h) arsyeja e përjashtimit nga TVSH-ja (në specifikimet të dhënat BT-120 dhe BT-121);
- i) kur fatura lëshohet për pagesa të bëra paraprakisht dhe TVSH llogaritet në momentin e marrjes së pagesës dhe e drejta e zbritjes lind në këtë moment, fatura duhet të përmbajë tekstin: "Parapagesë" (në specifikimet e dhëna BT-3=386);
- j) nëse një person i tatuueshëm, që vepron si blerësi ose klienti, është përgjegjës për pagimin e TVSH-së, fatura përmban tekstin: "Auto ngarkesë" (në specifikimet të dhënat BT-95=AE, BT-102, BT-118 dhe BT-151);
- k) në rast të aplikimit të një skeme të veçantë për agjencitë e udhëtimit, fatura duhet të përmbajë tekstin: "Skema e Marzhit – Agjentët e udhëtimit" (në specifikimet të dhënat BT-95=E, BT-102, BT-118, BT-120 që përmbajnë tekstin "Skema e marzhit – Agjentët e udhëtimit", përdorimi i mundshëm i BT-121 që përmban vlera nga lista e arsveve të përjashtimit të TVSH-së së CEF (VATEX) dhe BT-151);
- l) në rast të një prej organizimeve të posaçme të zbatueshme për mallrat e përdorura, veprat e artit, artikujt e koleksionistëve dhe antike, aplikimi i faturës përmban deklaratën: "Skema e marzhit – mallra të përdorura"; "Skema e marzhit – Veprat e artit" ose "Skema e marzhit – Artikujt e koleksioneve dhe antikët" përkatësisht (në specifikimet të dhënat BT-95=E, BT-102, BT-118, BT-120 që përmbajnë tekstin "Skema e marzhit – Agjentët e udhëtimit", përdorimi i mundshëm i BT-121 që përmban vlera nga lista e arsveve të përjashtimit të TVSH-së së CEF (VATEX) dhe BT-151);
- m) nëse tatimpaguesi është një person që zbaton skemën e marzhit, fatura përmban tekstin: "Shitje që i nënshtrohet skemës së marzhit të fitimit" (në specifikimet e dhëna BG1); n) nëse tatimpaguesi është organizator i shitjes me ankand, fatura përmban tekstin: "Shitje që i nënshtrohet skemës së ankandit" për çdo faturë të lëshuar blerësit në lidhje me shitjen me ankand (në specifikimet e dhëna BG-1).



Monika Farca

Managing Partner
AIMS International – Albania

» Vijn nga faqja 1

...dhe vendeve të ndryshme për të ndarë mënyrën se si janë përballur me COVID-19. Diskutimi kryesor gjatë këtyre seancave ishte në lidhje me sfidat që ata po përballen dhe masat që kanë marrë për të siguruar qëndrueshmërinë e veprimtarive të biznesit gjatë këtyre kohëve të pasigurta.

Kjo ka qenë një mundësi shumë e mirë për drejtuesit të ndajmë eksperjencat dhe idetë se si të marrin vendime më të shpejta dhe më të mira për burimet njerëzore dhe të planifikojnë veprimtaritë pas Coronës.

Sfidat kryesore të paraqitura nga HR dhe Drejtuesit e bizneseve përfshijnë:

» **Pandemia e COVID-19 nuk është një "çështje HR":** por, vete drejtuesit e lartë duhet të angazhohen dhe të bëhen më të arritshëm duke treguar anën e tyre njerëzore dhe të kujdesen për njerëzit. Papritur, jemi të vetëdijshëm se, përmes rritjes së takimeve online është e mundur për HR të përfshihet shpesh edhe me vendet më të largëta.

» **Shëndeti dhe siguria këne mare fokusin kryesor** nga punëdhënësit, konsumatorët dhe punonjësit. Komunikimi i sinqertë dhe transparent është i rëndësishëm për të ndihmuar në zbutjen e niveleve të larta të ankthit në organizata. Mbështetja e burimeve njerëzore tani shtrihet nga individi tek familjet e punonjësve dhe madje edhe në komunitetet.

» **Puna në distancë ka përfitime të mëdha, por** megjithëse ne kemi parë rritje të produktivitetit në shumë fusha në javët e para, kohët e fundit shohim ndikimin e çështjeve familjare. Si të ndryshojmë

mendësitë tona për të akomoduar një stil pune më të integruar për prindërit mbetet ndër sfidat kryesore.

» **Mbajtja dhe angazhimi i stafit është një sfidë e madhe;** Si të mbajmë dhe angazhojmë stafin tonë, veçanërisht ata që punojnë nga shtëpia? Si të integrojmë punonjësit e rinj kur nuk mund të organizojmë dot trajnime apo workshope prezantimi në punë?

» **Efektiviteti Organizacional (OE) duhet të ripërcaktohet.** Disa kanë kuptuar që për të vepruar më shpejt plani i vazhdimësisë së biznesit të tyre ka ndryshuar nga metoda tradicionale nga lart-poshtë në një metodologji nga poshtë-lart. Fuqizimi i drejtuesve

ne baze është bërë thelbësore. Vlerat që nxisin kulturën e kompanisë dhe veprimet po ndryshojnë - siguria dhe shëndeti vijnë të parat. Duhet analizuar çfarë do të thotë kjo për Efektivitetin Organizacional në biznesin tuaj.

» **Përgatituni për evolucionin e forcës punëtore** - ekziston një hendek aftësish midis kërkesës për talente dhe ofertës, veçanërisht në 4 aftësi kritike për të ardhmen:
- Inovacioni dhe kreativiteti
- Përshtatshmëria dhe fleksibiliteti
- Bashkëpunimi dhe Komunikimi
- Njohuritë dhe Aftësitë për Biznes

» **Mendësia Dixhitale është bërë përparësi.** Gjenerimi dhe mbani njerëz me mendësi dixhitale, jo domosdoshmërisht aftësi teknike dixhitale.

Sfidat e HR dhe Drejtuesve në normalitetin e ri



Si përfundim, profesionistët e HR po përballen me një sfidë të paprecendente për shkak të kësaj pandemie, duke pasur nevojë të forcojnë kulturën dhe vlerat e organizatave të tyre. Nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme të komunikosh në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente, të jesh fleksibël, të tregosh humanizëm, dhe angazhosh stafin në të gjitha platformat.

DISA NGA SFIDAT NË SHQIPËRI


» **Kërkesa në rritje për shërbime BPO** po terheq gjithnjë e më shumë talente shqiptare në të gjitha nivelet, nga teknikët deri tek profilet e menaxherëve. Italia mbetet vendi kryesor me kërkesën më të lartë për shërbime të reja BPO, të ndryshme nga shërbimet e call centers.

» **Pritet largim i trurit intelektual pas hapjes**-Shumë profesioniste shqiptar janë duke pritur hapjen e kufijve për të gjetur punë më të mira jashtë, ose i kanë tashme kontratat. Ndërkohë për shkak të pasigurisë, profesionistët e pershtatshëm për ti zevendesuar hezitojnë të konsiderojnë punëdhënësit të rinj.

» **Pritet një rritje e pagave për pozicione kritike** për shkak të luftës për talente. Kompanitë duhet të reagojnë me shpejtësi në plotësimin e boshllëqeve për talentet kyçe duke atraktuar talente nga industri të tjera të prekura me shume nga COVID.

» **Rritja e produktivitetit në distancë dhe motivimit të stafit.** Faktorët që duhet të adresohen nuk kanë të bëjnë vetëm me infra-strukturën e IT dhe platformat online. Përkundrazi, ato kanë të bëjnë me menaxhimin e njerëzve, menaxhimin e performancës dhe krijimin e njësive motivuese për punën në distancë. Kompanitë duhet të investojnë në ndërtimin e portofolit të aftësive të së ardhmes, duke përfshirë mendësinë dixhitale dhe aftësinë për të punuar në distancë dhe të trajnojnë stafin për keto aftësi. Mos hamendësoni se të rinjtë janë më të përgatitur. Një studim i fundit i SHL, vlerësues global i talenteve tregoi se të rinjtë shënuan më pak pikë se punonjësit me moshe më të lartë në disa kompetenca kritike të nevojshme për normalitetin e ri.

» **Te jesh punëdhënës me reputacion nuk është akoma prioritet për bizneset.** Kompanitë duhet të ri formulojnë strategjitë e menaxhimit të talenteve për të terhequr dhe mbajtur talentet e duhura. Roli i Departamentit të BNJ si partner strategjik merrendesi të vecante në keto kohë.



Juella Isaj

CEO
DDB Albania

Në mars kur ndodhi mbyllja, askush nuk e kishte imagjinuar se e ardhmja do të ndryshonte në mënyrë kaq dramatike brenda natës. Vit pas viti, industria e reklamave është duke u shndërruar me shpejtësi. Transformimi digjital në të gjitha nivelet ka qenë një nga sfidat kryesore të kësaj industrie. Ndërtimi i kapaciteteve, të dhënat që komunikojnë përmes krijimtarisë ishin procese që duhej të viheshin në zbatim brenda natës.

Normaliteti i ri do të vazhdojë

Asnjëherë më parë nuk e kishim menduar se seancat e shkëmbimit të ideve do të ishin funksionale edhe on-line. Seancat krijuese kanë nevojë për angazhimin e ekipit. Kreativiteti lulëzon në bashkëveprimin njerëzor. Pra, fleksibiliteti, empatia dhe siguri isht një përqëndrim më i mprehtë në të ardhmen e biznesit, janë të nevojshme për të mbajtur ekipet, të motivuar dhe të angazhuar.

Të punuarit SMART, duhet të vazhdojë kështu që ne i kemi përshtatur shpejt ekipet tona për të punuar në distancë.



Ndërprerja brenda natës dhe e ardhmja e reklamimit

SFIDAT FINANCIARE

Sektori i shërbimeve po vuan në të gjitha nivelet, veçanërisht në një treg ku situata financiare është mjaft e paqëndrueshme. Kështu, kur ulja e kostove është e vetmja mundësi për të mbijetuar, kostot e reklamimit janë më të lehtat për tu ulur.

Industria e reklamave nuk ka qenë shumë aktive në mbështetjen e interesave të veta.

Ndërsa besoj me vendosmëri se krijimtaria është me të vërtetë një forcë e fuqishme për të çuar biznesin përpara, ajo shpesh nënvlerësohet nga tregu lokal. Bizneset e shohin reklamën si një luks në vend të një force lëvizëse, dhe një mjet për t'i rregulluar ato në të ardhmen. Kjo bëhet me evidente në kohë të vështira.

Kështu që, nevoja për t'u përshtatur dhe për të mbetur relativë, është edhe më thelbësore gjatë këtyre kohërave.

KAPACITETET E NDËRTIMIT

Si në çdo sektor tjetër, të gjesh personel të kualifikuar ka qenë gjithmonë e vështirë. Megjithatë të rinjtë e duan reklamën, mungesa e arsimit të duhur mbetet një çështje e veshtire

per tu zgjidhur. Ka shumë nevojë për ndërtimin e kapaciteteve të tilla. Situata është akoma me e veshtire kur kaq shume te rinj vendosin te largohen nga vendi.

Punësimi i njerëzve me pasione dhe trajnimi i tyre në bord ka qenë përgjigja jonë për këtë sfidë.

OFRIMI I SHËRBIMEVE TË AVANCUARA MBETET PRIORITET KRYESOR PËR NE

Ne jemi këtu për të gjetur zgjidhje për klientët tanë. Zgjidhje që përfshijnë transformimin e tyre digjital. Me kompaninë tonë të grupit digjital ne ofrojmë zgjidhje të përshtatshme në bazë të secilit klient që duhet të zbatojë, shtyjë përpara dhe të rrisë praninë e tyre në treg.

Nga dyqanet virtuale te lojrat online, per tu shtrire me tej, ne ri-pozicionim dhe ri-marketim per tu përshtatur me shpejt me boten digjitale, janë zgjidhje që ne aktualisht u ofrojmë klientëve tanë.

Zgjidhje të tilla kanë nevojë për përkushtim, qëllime të qarta dhe shkallë mjaft të madhe të përshtatshmërisë. Kemi pasur mjaft fat që kemi klientë dhe partnerë që kanë

besuar procese të tilla me ne dhe jemi krenarë që kemi ndërtuar mjete që mbështesin projekte të pasurive të patundshme, projekte të NVM-ve, aplikime bankare etj.

Përmes zgjidhjeve tona, në bashkëpunim me klientët tanë, qëllimi ynë kryesor mbetet përmirësimi i eksperiences se klienteve te tyre. Ne përpiqemi ta bëjmë këtë, në çdo prekje digjitale, në mënyrë që çdo ndërveprim të përkethehet në një përvojë të rehatshme dhe unike.

Unë jam optimiste për atë që sjell e ardhmja, besoj fuqimisht se megjithëse kohërat janë të vështira, ka mundësi dhe rrugë të reja për tu eksploruar më tej. Industria jonë nuk punon nga zona e rehatisë, kështu që nevoja për të shpikur dhe ri-shpikur vetveten gjatë gjithë kohës dhe për të mbetur të zhdërvjellët, është ajo që na shtyn përpara dhe ajo që na nxit të ofrojmë zgjidhje të ndryshme.

Një gjë është e sigurtë, me gjithë zhvillimin e vazhdueshëm teknologjik, krijimtaria gjithmonë do të mbetet njerëzore dhe ajo gjithmonë do ta çojë biznesin përpara.

Pergatitur nga Boga & Associate

Akti Normativ

“Për Ndryshimet në Aktin Normativ Nr.9, datë 25.03.2020, Për Masat Speciale në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë Situatës Epidemike të shkaktuar nga Covid-19”.



Më 27 maj 2020, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ “Për Ndryshimet në Aktin Normativ Nr.9, datë 25.03.2020, Për Masat Speciale në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë Situatës Epidemike të shkaktuar nga Covid-19”.

Sipas këtij Ligji Normativ, gjatë shtrirjes së situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, gjykatat do të zhvillojnë seancat dëgjimore të çështjeve administrative, civile dhe penale, duke zbatuar masat e nevojshme për të shmangur grumbullimin në ambientet e gjykatës dhe sallat e gjyqit, më saktësisht:

- » (i) kufizimin e hyrjes së publikut në ambientet e gjykatës;
- » (ii) rregullimi i aksesit në shërbime, duke rezervuar përmes telefonit ose komunikimit elektronik, duke siguruar që përdoruesit të mund të përdorin shërbimet brenda një kohe të caktuar, dhe të miratojnë çdo masë që konsiderohet e nevojshme për të shmangur grumbullimin;
- » (iii) zbatimin e udhëzimeve de-tyruese për kufizimin dhe lëvizjen e personave;
- » (iv) Procedurat me dyer të mbyllura të të gjitha seancave dëgjimore publike;

» (v) Kryerja e seancave dëgjimore në çështjet administrative dhe civile, në të cilat nuk kërkohet prania e palëve, duke përdorur mjete elektronike të komunikimit për paraqitjen e akteve procedurale dhe vendimeve nga gjykatat.

Kushtet për ngritjen e padive, ankesat dhe kryerjen e çdo veprimi

procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, të cilat u pezulluan sipas Ligjit Normativ Nr.9, datë 25.03.2020, do të fillojnë të fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të Akti Normativ i datës 27.05.2020.

Ky Akt Normativ hyn në fuqi me efekt të menjëhershëm, pas botimit në Gazetën Zyrtare.

Akti Normativ

KËSHILLI MINISTRAVE SHFUQIZON PEZULLIMIN E PROCEDURAVE PËRMBARIMORE, TË NDËRMJETËSIMIT DHE FALIMENTIMIT.

Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 22, datë 27.05.2020 “Përshfuqizimin e aktit normativ nr. 13, datë 2.4.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbarimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, miratuar me Ligjin nr. 34/2020” (Akti Normativ nr. 22).

Akti Normativ nr. 22 synon të shfuqizojë aktin normativ nr. 13, datë 02.04.2020 të Këshillit të Ministrave i miratuar me ligjin nr. 34/2020, i cili pezullonte afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të përmbarusit gjyqësor shtetëror apo privat, ndërmjetësimit dhe administratorit në procedurat e falimentimit.

Akti Normativ nr. 22 hyn në fuqi menjëherë dhe është botuar me Fletoren Zyrtare nr. 98, datë 29 Maj2020.

Pergatitur nga Deloitte Albania



Welcomes



Kompania “DEKON FRIGO” është një kompani e specializuar në importimin, shpërndarjen, paketimin dhe përpunimin e produkteve të mishit. Në fillimet e saj ka qenë pjesë e grupit CAMPO FRIO, i themeluar në vitin 1992. Më vonë, në vitin 2007 u krijua kompania DEKON FRIGO dhe u mundësua investimi në ndërtimin e dhomave frigoriferike për magazinim dhe përpunimin me kapacitet frigoriferik prej 1200 ton, në një hapësirë prej 6000 m². Teknologjia e përdorur në ndërtimin e dhomave frigoriferike dhe pajisjeve është sipas standardeve evropiane, konkretisht atyre italiane. Kompania është certifikuar sipas Sistemit të Autokontrollit Higjieno-Sanitar H.A.C.C.P UNI 10854: 1999. Dekon Frigo është një nga kompanitë kryesore të industrisë së importit të produkteve të mishit të pulës, të viçit dhe të dërrit. Produktet e portofolit të kompanisë janë me origjinë nga SHBA-ja dhe Bashkimi Evropian. DEKON FRIGO disponon një gamë të gjerë artikujsh ushqimorë për HORECA dhe supermarkete dhe ofron lëndën e parë për prodhimin e nën produkteve të mishit. Rrjeti i shpërndarjes mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë dhe gjithashtu zotëron disa dyqane të shitjes me pakicë dhe shumicë. Përvoja e gjatë, sistemi i konsoliduar logjistik dhe efikasiteti i personelit të kualifikuar dhe të motivuar i kanë dhënë DEKON FRIGO-s ngjyrat e një partneri profesional dhe të besueshëm në tregun shqiptar.

COVID 19- ECONOMIC NEWS



TRANSPORTI PUBLIK FILLON TË FUNKSIONOJË PËRSËRI NGA 15 QERSHORI

Sipas njoftimit të Ministrisë kapaciteti i mjeteve të transportit nuk duhet të jetë i mbushur më shumë se 70%. Të gjithë qytetarët që hipin në mjetet publike duhet të mbajnë maska me detyrim.



"NDIHMONI TRANSPORTIN NDERURBAN" - OPERATORËT, KËRKESA E QEVERISË: NA SHPËTONI NGA FALIMENTIMI

Operatorët e transportit interurban i kanë kërkuar qeverisë miratimin e një pakete ekonomike, për të shpëtuar nga falimentimi. Përmes një manifestimi të zhvilluar para Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ata kanë kërkuar heqjen e akcizës

së naftës, uljen e TVSH-së nga 20 në 6% si dhe faljen e taksave lokale.

KRIZA ZBEH RIMBURSIMIN E TVSH-SË, NË RËNIE VJETORE 4-MUJORE ME 11%

Ritmet e rimbursimit të TVSH-së shënuan ulje gjatë katërmujorit të parë të vitit si pasojë e goditjeve të shumanshme që dha pandemia. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave gjatë katërmujorit u rimbursuan 4,6 miliardë lekë TVSH me një rënie 11 për qind për qind nga viti i kaluar.



SI DO TË SHPËRNDAHET "BONUSI I LUFTËS"? - HAPAT QË INDIVIDËT DUHET TË NDJEKIN NË MËNYRË QË TË MOS HUMBASIN PAGESA

Duke filluar nga dita e Hënë do të fillojë të shpërndahet bonusi i luftës prej 40 mijë lekësh për individët përfitues të cilët ende nuk e kanë marrë, pavarësisht se punëdhënësit e tyre nuk kanë aplikuar për ta. Sipas burimeve zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për një pjesë prej tyre për të cilët

administrata disponon të dhënat e llogarive bankare, pagesa do të bëhet në mënyrë automatike.

EUROBONDI, AMNISTIA, FISKALIZIMI, RAMA: TREGJET NA BESUAN, JA ÇFARË DO BËJMË NË VIJIM


Qeveria shqiptare ka arritur të emetojë një Eurobond me vlerë 650 milionë euro në tregjet ndërkombëtare, me një kupon prej 3.65% për një afat 7 vjeçar. Përqindja vlerësohet si tepër e favorshme nga ekspertët, sepse Maqedonia që ka një vlerësim BB+ ka marrë interes më të lartë dy javë më parë.



TEKSA INVESTIMET E HUAJA BIEN ME 20% NË TREMUJORIN E PARË, BIZNESET SHQIPTARE PO I INVESTOJNË PARATË JASHTË!

Shqipëria do të përballet shumë shpejt me një emergjencë, teksa investimet e huaja janë në rënie, si rrjedhojë e mbarimit të TAP dhe krizës së Covid-19, në një kohë që sipërmarrësit shqiptarë po preferojnë që të investojnë fondet e tyre të lira jashtë vendit. Në tre muajt e parë të 2019-s,

sipërmarrjet shqiptare investuan 12 milionë euro jashtë.



PASTRIMI I PARAVE, PAS REKOMANDIMIT TË MONEYVAL DO KRIJOHET REGJISTRI PËR OJF-TË, GATI PROJEKTLIGJI

Shqipëria do të krijojë regjistrin e organizatave jofitimprurëse në një përpjekje për të plotësuar rekomandimet e bëra nga Moneyval për të minimizuar riskun e pastrimit të parave. Ministria e Drejtësisë tashmë ka gati draftin e parë të projektligjit "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" i cili është në fazë konsultimi teksa vihet theksi në të gjithë elementët që do të shoqërojnë këtë proces.

KREDITË ME PROBLEME RRITEN LEHTË NË PRILL, PËR TË DYTIN MUAJ RADHAZI

Huatë që nuk kthehen në afat në banka shënuan një rritje të lehtë në prill për të dytin muaj radhazi, sipas statistikave të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Në prill, ky tregues arriti në 8.28%, nga 8.18% që ishin në shkurt, kur huatë e pakthyer kishin arritur në nivelin më të ulët në 11 vjet.